

NDËRTIMET TRADICIONALE SHQIPTARE SI OBJEKT STUDIMI ETNOLOGJIK

ALI MUKA

Etnolog, Tiranë, Shqipëri

E -mail: liosham@yahoo.com

Në vend të hyrjes.

Fillimisht desha të falenderoj organizatorët e njëherazi drejtues të këtij aktiviteti të nderuar, për ftesën dhe mundësinë e mbajtjes së kësaj kumtese. Është nder e kënaqësi gjithashtu që, të përshëndes të gjithë të pranishmit, duke ju uruar punë të mbarë dhe sukses. Tema që vihet në fokusin e këtij kumtimi modest, përfshin aspekte që, përpiqet të ruajë si sfond, objektin e këtij aktiviteti, të gjerë për nga natyra e disiplinave a fushave që ve në fokus. Trashëgimia jonë ndërtimore, është e pasur për nga arritjet dhe e larmishme për nga gjinitë, me shtrirje që fillon prej muzgut të historisë së kësaj etnie, duke ardhur deri në ditët tona. Fjala është për gjini të tilla si, **arkitektura popullore, ndërtimet e kultit** (kristiane e myslimane), ato **inxhinjerike** dhe ndërtimet **fortifikuese**. Kjo trashëgimi ka rrugën e zhvillimit, arritje e vlera në mbarë arealin tradicional të banuar nga shqiptarë etnikë. Areal që nënkupton jo vetëm territorin brenda kufijve aktualë të Shqipërisë, por dhe Kosovën, trevat shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi e në Çamëri (Greqi).

Secila nga gjinitë ndërtimore të përmendura, bart tipare që e dallojnë, nga të tjerat. Këtu po ndalem te ndonjë tipar të secilës, në raport me **arkitekturën popullore**. Fjala vjen, **ndërtimet e kultit**, pavarësisht shkallës së zgjidhjeve arkitektonike, e funksionit (Kishë, paraklis, xhami, tyrbe, teqe etj.), janë ngritur të paraprirë me kushtëzime të diktuar nga **programime kanonike**. Në **ndërtimet fortifikuese** (kalatë në përgjithësi), në karakterin e në fizionominë e tyre dhe teknikën e ndërtimit, gjen të materializuar **shkallën e zhvillimit të teknikave të luftimit**. Kujtoj që, një kala e ndërtuar para daljes së armëve të zjarrit, nuk ka të njëjtat tipare me atë të ndërtuar pas daljes së tyre. Tipare të vetat dalluese kanë dhe **ndërtimet inxhinjerike** (ura, mullinj, diga, kanale etj.). Karakteri dhe shkalla e zhvillimit të tyre, lidhen me shkallën e zhvillimit të **teknologjive ndërtimore** dhe me futjen në përdorim të materialeve të reja. Njëherazi duhet

theksuar se, te të gjitha këto gjini ndërtimore, nuk mungojnë **nota individualiteti** të lidhura me etninë e me trojet, pasuri e të cilve janë. Veçse studiuesit kanë të drejtë kur thonë që, ato nuk mund të konsiderohen, thjesht produkt i këtij apo i atij etnosi, në kuptime rigorozë të termit. Në një kohë që, ndryshe prej tyre, arkitektura popullore, me frymën e me tipare me nota individualiteti si krijimtari, lidhet me karakterin e kombit të cilit i përket.

1. Pjesë e etnokulturës

Një ndër treguesit e prekshëm në kulturën e një populli, mbetet **mënyra e jetesës**. Edhe **mënyra e të banuarit**, si pjesë organike **kulturës së banimit**, konsiderohet si një nga shfaqjet e hershme të kulturës në përgjithësi. Etnologët thonë se, **banesa** është bashkëudhëtare e njeriut, së bashku me **veshjen** dhe me **ushqimin**. Kundruar kështu, banesa mbetet dëshmi historike dhe kulturore, për cilëndo etni, komb a popull me rrënjë të hershme ngulimi në trojet e veta. Si e tillë kjo trashëgimi, mbetet pjesë e natyrshme e **kulturës popullore** (apo e **etnokulturës**), dhe njëherazi, pjesë po aq e natyrshme e **kulturës kombëtare**. Ndërtimet tona tradicionale të banimit (të realizuara në fshat a në qytet), nuk i ka paraprirë asnjë projekt i hedhur në letër, ndonëse cilindo shembull banese, e karakterizon zgjidhje logjike për kohën kur është ndërtuar; çka nuk do të thotë se janë realizime spontane. Fillesat e saj lidhen me kohën kur njeriu filloi të bëjë jetë sedentare të organizuar në vendbanime të ngulitura. Pra lidhet me atë fazë kur njeriu i pajisur me ndërgjegje, filloi të transformojë natyrën në dobi të vet, duke krijuar atë që sot quhet "natyra e dytë", kundruar gjithnjë si pjesë e të parës. Në këto kuptime, ajo është mishërim i përvojës së brezave. Me kalimin nga një fazë në tjetrën, përvoja dhe arritja e shënuar nga njeri brez, trashëgohej nga ai pasardhës, duke u kthyer në traditë me tipare thelbësore origjinale.

Gjatë gjurmimeve shumë-vjeçare në fshatra (jo vetëm brenda Shqipërisë aktuale), më ka tërhequr shpesh vemendjen një shprehje e të moshuarve. Ata më

pohonin: *planin e shtëpisë e baj vet, ustai e ndërton*. Pra, fshatari nevojtar i parashtronte mjeshtrit kërkesa konkrete për banesën që do të ndërtohej. Këto kërkesa mbanin si bazë nisjeje, banesën ekzistuese të kësaj familjeje, pa përjashtuar ndonjë banesë tjetër në atë lagje, fshat a zonë. Besoj të më mirëkuptojë ndonjë koleg (sidomos arkitekt a inxhinjer i pranishëm), nëse pohoj që, kërkesat e parashtruara nga fshatari, përbënin në thelb, atë që në gjuhën e specialistëve quhet *program* i banesës së ardhshme të fshatarit. Ky program, gjithashtu i pa hedhur në letër, i pa shkruar, ka në sfond të paktën dy anë të lidhura e të ndërthurura me njera-tjetrën. Së pari, lidhjen organike me truallin apo me mjedisin ku do të jetonte familja që po ngrinte shtëpi të re. Aty, në atë ambient do të niste e do të merrte formë oborri i banimit të saj. Pozicioni i vendosjes zgjidhej i tillë që të lehtësonte lidhjen me zonat ekonomike të familjes (si ara, kullota, burime të ujit), por dhe me fshatin (si rrugë) etj. Por dhe gjymtyra e dytë e shprehjes që përmenda më lart, ka domethënien e vet, hedh dritë për lidhjen e ndërsjellë midis mjeshtrit ndërtues e pronarit të banesës që do të ngrihej.

Realizimet që trashëgojmë dëshmojnë se, çdo hap e kërkesë e njerit, nënkupton mirëkuptimin ose jo të tjetrit. Çka do të thotë se, duke dëgjuar e marrë në konsideratë kërkesat e porositësit, mjeshtri fuste njëherazi në veprim, përvojën e vet ndërtuese. Ky çast me shumë rëndësi, nënkupton se, mjeshtri mund të materializonte kërkesat e porositësit, mbi bazën e përvojës së vet ndërtuese, pa e kuptuar këtë si ngushtësisht teknike. Mjeshtri dhe pronari qëndronin pranë e pranë, duke plotësuar e korigjuar çdo gjë në procesin e ndërtimit të banesës; korigjime a plotësime që bëheshin atypëraty. Theksoj gjithashtu se, roli i porositësit merrte rëndësi, përveç në paracaktimin e truallit të ndërtimit, dhe në probleme të karakterit funksional (numri e përmasat e kateve, të kthinave, formulimi e pozicioni i vendosjes në raport me njera-tjetrën). Ndërsa për probleme të karakterit të ngushtë teknik, kjo përparësi i kalonte mjeshtrit ndërtues. Dhe kjo çka u tha shkurt, zbulon dallimin midis një ndërtimi tradicional e një tjetri të realizuar nga specialisti i shkolluar. Mjaft të them se fshatarit nuk i mungonte përvoja ndërtuese ndërsa mjeshtri njihnte mirë mënyrën e banimit e të jetesës së familjes fshatare, pasi dhe ai kish dalë nga ai brumë. Në këtë kompleks marrëdhëniesh, pa e nënvlerësuar rolin e porositësit, nuk është e rastit që emri i mjeshtrit ka mbetur ende në kohën tonë, i arkivuar në kujtesën e popullit, në gjirin e të cilit ai punoi e nga ku mori *diplomën*, bazuar në *intuitë* e në *përvojë*, të trashëguara në breza. Te bashkëpunimi midis tij e pronarit dhe te detyrimet e

ndërsjella, qëndron dhe *fryma popullore* e realizimit të banesës. Ajo na vjen kështu, si bartëse e një përvoje të gjatë njohëse dhe si mishërim natyror i frymës kolegjiale. Modeli ekzistues, i cili merrej si bazë nisjeje, nuk riprodhohej mekanikisht, por shërbente si nxitës i një realizimi të ri. Elasticiteti në riprodhim e përpunim, ish i pranishëm. Ky elasticitet shënon një nga anët më të rëndësishme të frymës origjinale që bartin ndërtimet e banimit që trashëgojmë nga e kaluara. Si e tillë, kjo trashëgimi, përbën një dëshmi autentike me vlera që i kanë rezistuar kohës, duke hedhur dritë dhe mbi aftësitë krijuese të bartësve e realizuesve të saj.

2. Klasifikimi tipologjik

Për klasifikimin tipologjik të banesës, janë njohur faktorë nga më të ndryshmit e që, kanë çuar në përfundime të ndryshme. Pa mohuar vlera të secilit prej tyre, nuk kanë munguar dhe zbatim kriteresh formaliste, ku ndonjeri prej tyre, mund të quhej i gabuar e deri tendencioz. Në klasifikime të tilla, banesa shihet jashtë zhvillimit historik, si një dukuri e pandryshueshme në kohë dhe në hapësirë. Pra, jo çdo kriter ka vlerë bindëse. Banesa tradicionale klasifikohet, fjala vjen, sipas *materialit kryesor ndërtimor* të përdorur në ngritjen e mureve të saj. Në këtë rast mund të flitej për banesa me mure *guri*, me *qerpiçi*, me *tulla*, me *dru*, apo me kombinime të tyre. Një klasifikim tjetër bazohet në *teknikën e ndërtimit* të zbatuar në ngritjen, fjala vjen, të mureve. Në këtë rast mund të flitej për banesë me mure *masive*, me *sklet*, apo me strukturë të kombinuar të dy llojeve. Një klasifikim tjetër mund të bëhet sipas zhvillimit në lartësi. Në këtë rast mund të flitej për banesa *përdhese*, me *gjysmëkat*, me *kate* dhe kombinime të tyre. Kriteri mund të nisej nga *lloji i çatisë*, struktura mbajtëse e saj, lloji i materialit të përdorur në mbulesë (tjegulla, rrasa guri, furde etj.), *forma e jashtme e mbulesës*, apo *numri i flegrave* (a kullimeve), të kësaj mbulesë. Klasifikimi mund të bëhet mbi bazën e *numrit të kthinave të banimit* apo *dispozicionit planimetrik*. Çka nënkupton banesë me një kthinë, me dy etj. Ka klasifikim që mban në themel të vet degën kryesore ekonomike të familjes: *blegtorale*, *bujqësore* etj. Si kriter merret *pozita ekonomike* e familjes: e *varfër*, e *pasur* etj. Si bazë nisjeje mund të merrej *relievi i vendosjes së banesës*: në fushë, në luginë, në kodër, në shpat, në rrafshnaltë, në mal etj. Klasifikimi mund të nisej dhe nga *madhësia numerike e familjes*, apo *stuktura e brendshme e saj*: e vogël, e madhe, me shumë kurorë të martuara etj. Takon dhe klasifikime ku gjen të zbatuar kriterin *territorial-hapësiror*, siç do të ish *areali gjeografik*. Ka klasifikime që kanë si bazë nisjeje *përbërjen etnike, kombësinë* etj.

Sikundër u pa, pa u ndalur te ndonjë klasifikim tjetër, të cilët janë të shumtë për nga numri e të larmishëm, shtoj se ndonjë prej tyre, ka gjetur zbatim edhe në studime të botuara në Tiranë apo në Prishtinë. Studiuesit theksojnë se, ndonëse secili prej tyre, ka vlera të vetat, asnjëri nuk ka *natyrë gjithpërfshirëse*, çka e bën të diskutueshëm vënien në zbatim. Them kështu, pasi fjala vjen, banesa me mure guri nuk gjen vetëm në troje të një populli, vetëm në një areal a zonë të ngushtë, pra të palidhur thjesht e vetëm me një etni të caktuar në vështrim etnologu. Studimet tona, kanë argumentuar në mënyrë bindëse se, klasifikimi më i drejtë shkecor është ai që nisët nga *zhvillimi planimetrik-vëllimor i banesës*, i cili mundëson marrjen në konsideratë të cilitdo faktor tjetër, si plotësues në raport me të. Ai ndihmon që *kultura e banimit*, si pjesë e *mënyrës së të jetuarit*, të njihet nëpërmjet kategorive të tilla evolutive kompozicionale si: *tipi, varianti, nënvarianti*, me shembuj konkretë brenda secilës. Për më tepër, ky kriter lehtëson vendosjen e dukurisë sipas një kronologjie relative, çka shmang çdo vështrim të ngushtë teknik. Vetëm përmes tij, larmia e skemave në plan e në vëllim hedh dritë mbi shkallën e plotësimin të nevojave kryesore jetësore të familjes. Krijohen mundësi praktike për të ndjekur zhvillimin e banesës nga zgjidhja më e thjeshtë e në vazhdimësi. Pra, përmes zbatimit të këtij kriteri, etnologu ndjek hap pas hapi karakterin historik të zhvillimit të kësaj dukurie etno-kulturore. Dhe që të mos mbeten këto pohime, me ndonjë ngjyrim formalist, po ndalem te një shembull konkret banese, e cila në botime jo të pakta të studiuesve të Tiranës, njihet me emrin *Banesa me shtëpinë e zjarrit në mes ose Banesa tiranase*, nga që gjurmët më të shumta, përfshirë dhe shembujt më të arrirë, janë konfirmuar në trevën e Tiranës. Jo vetëm në rrethinën fshatare (në fshatra fushore, kodrinore e malore), të kësaj qendre qytetare (të njohur tanimë dhe si vendbanim i lashtë), por dhe brenda në qytet. Po ndalem te ky shembull (aspak i vetmi), pasi ajo bart nota individualiteti e origjinaliteti që lexohen nga zgjidhje të thjeshta te ato të arrira. Individualiteti i saj, dëshmohet në kompozimin planimetrik-vëllimor e në zgjidhjen funksionale, të cilat e dëshmojnë të lidhur me familjen e madhe, qoftë për nga numri i njerëzve ashtu dhe nga numri i kurorëve të martuara, që kanë bashkëjetuar nën një *kulm*. Dihet se familja e madhe, përbën një kategori të njohur në mbarë shoqërinë njerëzore, të lidhur me etapa të caktuara të zhvillimit të saj historik. Atë e ndesh të realizuar me mure qerpiçi, guri, druri, tullash e me kombinime të këtyre materialeve. E gjen me çati të mbuluar me tjegulla, me rrasa guri, me furde e me kombinime të tyre. Por kompozimi

planimetriko-vëllimor, mbetet tregues mjaft domethënës. Ai karakterizohet nga një nyje e fuqishme qëndrore, e njohur me emrin *shtëpia e zjarrit*, rrotull të cilës shtellohen në një ose në dy kate, kthina të tjera. Kjo nyje ka përmasa të ndjeshme në plan e në vëllim dhe shkon me lartësi përtëgjatë dy kateve. Ajo ka mbetur në çdo shembull konkret, epiqendër në jetën e përditshme të familjes. Zgjidhja më e thjeshtë e saj është banesa njëkthineshe. Me kohë vendosen rreth kësaj bërthame, kthina të tjera të përmasave e formulimeve të ndryshme, të cilat ndërlidhen së brendshmi me të, duke pasur kështu komunikim të drejtpërdrejtë. Pjesa më e madhe e këtyre kthinave kanë shërbyer për fjetjen e çifteve, ndërsa një pjesë tjetër për nevoja ndihmëse-ekonomike të familjes. Kompozimi dhe formulimi i brendshëm i kthinës qëndrore (*shtëpisë së zjarrit*), flasin për prani konceptesh të lashta banimi e jetese. Lexojmë aty dhe shkallën e qëndrueshmërisë së tyre në kohë, duke vazhduar jetesën e mbijetesën deri vonë. Pa mohuar nota individualiteti në këto troje, ky koncept kompozicional e funksional, në kuptime të përgjithshme, ka qenë njohur në treva mesdhetare e më gjerë.

Ndër rezultatet më të rëndësishme të punës së kryer deri tani nga studiuesit tanë të kësaj fushe të trashëgimisë etnokulturore, përveç gjurmimit, dokumentimit e pasurimit të arkivave (fototekë, filmotekë, skicotekë), vështirë të pavlerësueshëm sot e në të ardhmen, është trasimi i tipologjisë së banesës tradicionale, duke vënë në themel *kriterin e kompozimit planimetriko-volumor*. Kjo tipologji njeh dy etapa të mëdha zhvillimi. Kufiri ndarës kohor i tyre silltet rreth mesit të *shek. XIX. E para* ka në sfond formacionin feudal në zhvillimin e shoqërisë shqiptare të kohës, kurse *e dyta*, duke qenë vazhdim logjik i të parës, ka në sfond procese të lindjes e të zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste në trojet tona. Po ashtu, studiuesit dallojnë midis këtyre dy etapave dhe një periudhë zhvillimi, të cilën e kosiderojnë si *kalimtare*. Në këtë fazë kalimtare, del mirë në dukje nga një anë zbehja graduale e dukurive thelbësore të lidhura me etapën e parë dhe nga ana tjetër, procesi i lindjes e konsolidimit të risive të lidhura me etapën e dytë. Kjo mënyrë analize e shqyrtimi, ka bërë të mundur zbulimin e mbijetesës së kësaj apo të asaj dukurie, si dëshmi zhvillimi të ngadaltë në shoqërinë shqiptare të kohës. Studiuesit tanë kanë trajtuar banesën tradicionale edhe sipas një ndarjeje tjetër, e cila ka gjetur pasqyrim të qartë në këto 30-40 vitet e fundit. Në fokus është vënë *banesa fshatare* dhe *banesa qytetare*. Kjo ndarje, me domethënie historike e aktuale, hedh dritë mbi atë realitet që karakterizon të

dy tipet e vendbanimeve në këto troje; pa lënë pas dore bashkëmarrëdhënie e ndikime të ndërsjella të tyre, në kohë e në hapësirë. Njëherazi duhet mbajtur parasysh se, edhe shqyrtimi tipologjik i *banesës qytetare* është bërë veçmas nga ai i *banesës fshatare*, lidhur me zhvillimin e tyre në periudhën e formacionit feudal.

Duke ruajtur po atë kriter, banesa fshatare është shqyrtuar mbi bazë **grupimesh krahinore**. Brenda secilit grupim, është filluar nga zgjidhjet e thjeshta e duke arritur deri te ato të zhvilluara. Praktikohej njihen 6-7 *grupime të tilla krahinore*. Tre prej tyre (krahinat *Veriperëndimore*, ato *Verilindore* e ato të *Masivit Qëndror të Shqipërisë Veriore*), i përkasin **grupit të madh të Gegërisë**. Tre të tjerë (*Ultësira Perëndimore*, Krahinat *Jugperëndimore* dhe ato të Shqipërisë *Juglindore*), i përkasin **grupit të madh të Toskërisë**. Një grupim formon *Skaji Jugor* (Çamëria), ndërsa një tjetër e formon **Grupi Kalimtar**, i cili shtrihet midis dy grupeve të para (Gegërisë e Toskërisë), përgjatë luginës së lumit Shkumbin, kryesisht në të majtë të rrjedhjes së tij. Ky rajonizim tipologjik i banesës fshatare, gjen mbështetje logjike edhe te Ndarja e Madhe Krahinore që ka ekzistuar në gji të popullit shqiptar dhe që e ka trajtuar pionieri i etnografisë shqiptare, Rrok Zojzi. Ky shqyrtim ka nxjerrë në dritë se, cilado krahinë, pavarësisht grupit që i përket, nuk e ka banesën të zhvilluar në mënyrë të shkëputur nga krahina kufitare me të. Aty, në cilindo rast, vihet re vazhdimësi logjike në kalimin nga njera tek tjetra, apo te të tjerat. Ky studim me baza shkencore, ka marrë në konsideratë dhe aspekte të huazimeve, ndikimeve a paraleleve, me popuj e me etni të tjera, sidomos të afërta në vështrim gjeografik-hapësiror. Kushtet historike-shoqërore të ngjashme e marrëdhëniet reciproke të fqinjësisë, i kanë bërë ato me karakter të ndërsjellë. Moment me rëndësi shënojnë karakteristikat, funksioni apo vendi që ze elementi i huazuar, çka ndihmon në leximin e gjuhës funksionale e arkitektonike dhe raportin e tij me elementë të tjerë. Përvoja jonë gjurmuese e studimore ka dëshmuar se, një element i huajtur, me kohë, në përputhje me nevoja e shije të marrësit (mjeshtri a fshatari qoftë), të jetë shkriër gradualisht me traditën, t'u jetë nënshtruar ligjeve të brendshme të zhvillimit të kësaj tradite, duke u shndërruar në pjesë përbërëse të saj. Çka do të thotë se, elementë të tillë, nuk kanë arritur të tjetërsojnë nota origjinaliteti e individualiteti të kësaj trashëgimie.

3. Objekt studimi etnologjik. Banesa, ashtu si dhe mjaft dukuri të tjera të kulturës materiale, është po aq dukuri interesante dhe komplekse e jetës shoqërore, siç janë *veshja, ushqimi* etj., të cilat e përcjellin jetën e

njeriut në mënyrë të vazhdueshme. Studimi i banesës përfshin aspekte *teknike-arkitektonike, historike-etnografike, sociologjike, natyrore-gjeografike, ekonomike-shoqërore*, çka e dëshmon objekt studimi ndërdisiplinor. Si pjesë e kulturës materiale, sikundër u tha më lart, ajo pasqyron *mënyrën e jetesës* së familjes që banon në të. Në këtë rrafsh ajo mbetet objekt studimi **etnologjik**. Kjo disiplinë e studion banesën jo vetëm si vend strehimi të thjeshtë për njeriun. Para së gjithash, ajo interesohet për zgjidhjen funksionale, mjediset, formulimin, orendimin e pajisjen e tyre. Etnologu interesohet jo vetëm për mjedisin e përfshirë brenda mureve të një banese, por dhe për hapësirën që e rrethon, oborrin me ndërtime e instalime që përfshihen aty. Studimi etnologjik ka në fokus gjithashtu tradita e zakone të lidhura me banesën, duke filluar nga zgjedhja e përcaktimi i truallit ku ngrihet ajo, hapja e themeleve, ngritja e mureve, ndërtimi i çatisë e i vatrës së zjarrit. Interesohet për procesin e hyrjes së familjes për herë të parë në shtëpinë e re, për zakone e tradita të lidhura me raste festash a ceremonish të natyrave të ndryshme. Pa u ndalur më gjatë, edhe me kaq sa u tha, merr përgjigje pyetja: **Përse e studion banesën etnologjia?** Sepse banesa duke mbetur një komponente e rëndësishme e mënyrës së jetesës, nuk ka vetëm domethënie materiale, por dhe shoqërore e kulturore. Prandaj dhe nuk është rastësi interesimi i *etnologjisë* në studimin e saj, duke e kundruar atë si pjesë të *etnokulturës*. Ky studim zbulon si plotësoheshin kërkesat e familjes për qëndrim, fjetje, ngrënie e gatim, pritjen e mikut, kalimin e *gëzimeve të mëdha* (dasma) a të *hidhërimeve të mëdha* (vdekje) etj. Pikërisht njohja, përshkrimi e analiza e aspekteve që u përmendën, i jep përgjigje dhe një pyetjeje jo pa interes asaj që e dallon një banesë të realizuar me projekt paraprak specialisti, nga banesa popullore. Është kjo një arsye e fortë që na kujton se dhe metoda e studimit, nuk mund të jetë e njëjtë me rrugën që do të mund të ndiqej për analizën e të dytës. Metoda e analizës, shkon përshtat me ligjëtoritë e zhvillimit të secilës. Prandaj dhe nuk e kanë gabim ata që pohojnë se, *banesa është shfaqja më e dukshme e njëherazi më personalja, e tipareve etnike*. Përvoja e studiuesve tanë, e ka provuar në mënyrë bindëse këtë realitet. Moment i rëndësishëm në kundrimin etnologjik të saj është dhe zbulimi, njohja e shqyrtimi i zakoneve, praktikave, veprimeve, riteve, që fillojnë qysh me zgjedhjen e truallit, me ndërtimin e banesës e hyrjen e familjes brenda, me gëzime e me hidhërime të mëdha të familjes, e kështu me radhë. Të kujtojmë, fjala vjen, *flijimet pa gjak*, apo *flijimet me gjak*, thelbi i të cilave, duke dëshmar origjinë pagane, lidhet me mendësi të parandalimit të

të këqijave e të nxitjes së mbarësisë. Në shyrtimin etnologjik një vend me peshë ze njohja, vlerësimi e respektimi i disa kulteve. Po kujtoj kultin e Diellit, kultin e Tokës, kultin e të Parëve etj. Prapa të cilave lexohet ideja e pengimit të çdo të keqeje, ideja e marrjes me të mirë të tyre, e kështu me radhë, duke iu atribuar atyre rol *padroni mbrojtës*. Pa folur për kultin e banesës e **kultin e mikpritjes**, mishërim i të cilëve është dhe *oda e miqve*, të cilës i rezzervohet vend i veçantë në formulimin e përgjithshëm të banesës.

Pra studimi i saj nuk nënkupton zbatim parakonceptesh në formë klisheje. Ku natyrisht nuk bëhet fjalë për mos njohje të përvojës botërore. Po ashtu, dëshmon se janë shmangur rendjet pas dukurive jo thelbësore, apo pas paragjyqimeve të cilat, për hir të së vërtetës, nuk kanë munguar në literaturë, duke mbajtur parasysh dhe botime të ndonjë studiuesi, ku takon gjykime apriori, të pabazuara në materialin faktik, lidhur me raportet e kësaj dukurie etnokulturore, ndërmjet popujve. Kur e pyetën një arkitekt europian se, *Ç'është kombëtare në arkitekturën e banesës?* Ai theksoi se, *Kombëtare në të është ajo që e dallon francezin nga gjermanin, gjermanin nga italianin e kështu me radhë*. Dhe unë besoj se nuk përbën nonsens, po t'i shtoja kësaj përgjigjeje logjike se, *Kombëtare në këtë sfond është edhe ajo që dallon kulturën e banimit e të jetesës së familjes tradicionale shqiptare nga ajo e cilitdo vendi a populli tjetër, qoftë ky dhe fqinj*. Dhe, i bindur në mirëkuptim, studimet shqiptare në këtë fushë i janë shmangur çdo lloj vështrimi me sens anakronik nacionalist. Çka do të thotë se, është synuar paraqitja reale e rrugës së zhvillimit, përfshirë dhe ndikime të natyrës së ndërsjellë. Moment me rëndësi mbetet fakti që, duke mos harruar thelbin e origjinalitetit e të individualitetit të etnisë e të kombi të cilit i përket, të mos fyesh a injorosh askënd, por dhe pa e paraqitur të vetën si "qendra e botës". Më ka lënë mbresa diçka që kam lexuar kohët e fundit. *E mira e çdo populli në Ballkan, është e mirë, kur është e mira e të gjithëve, kur është pjesë e të mirës së përgjithshme. Nuk ka të mira që dëmtojnë të tjerët*, thekson autori. Çka do të thotë se, na bie detyrë morale e qytetare të shohim larg, duke mos rënë pre e gjykimeve të çdo natyre që bie ndesh me kohën e me kërkesat e saj.

4. Arkitektura tradicionale dhe koha

Siç u vu në dukje, studimi me kritere shkencore i arkitekturës popullore, fillon aty nga gjysma e dytë të shek. XX. Dinamika e punës për gjurmimin, njohjen, dokumentimin, vlerësimin e vënien në mbrojtje shtetërore të shembujve më të arrirë, u kombinuan me kualifikimin e kuadrit specialist. Këtu është vendi të theksohet puna e kryer për vënie në mbrojtje

shtetërore, të mjaft banesave, komplekseve të banuara e deri qytete complete, duke i shpallur Monumente Kulture, Zonë-Muze e deri Qytet-Muze. Madje, rruga e ndjekur ka çuar në rezultate krahasimisht të dukshme, në raport mbarë hapësirën ballkanike, ku tre konsiderohen faktorët që e kanë favorizuar këtë realitet. *Së pari*, prapambetja krahasimisht e dukshme e Shqipërisë (bëhet fjalë për shtrirjen e cunguar), në raport me shumicën e vendeve të tjera ballkanike; së dyti, arritje më të dukshme të trashëgimisë sonë në këtë fushë dhe *së treti*, kujdesi i treguar nga organizmat institucionale-shkencore, të ngarkuara me këtë trashëgimi. Ndërkohë, nëse në Shqipërinë politike të gjysmës së dytë të shek. XX, rezultatet i ka dalluar natyra e njësuar në metodikën kërkimore-shkencore; ky pohim nuk është i të njëjtit nivel për Kosovën; ku ndonjëse trashëgimia ishte tejet e pasur, interesimi i organizuar për të, linte për të dëshiruar. Ndërsa ka shkrime nga kjo fushë, evidentohet mungesë sistematizmi dhe përkujdesjeje për vënie në mbrojtje. Mjaft të kujtoj se, 30 vjet më parë, konkretisht në vitin 1980, numëroheshin 210 ndërtime fshatare të vëna në mbrojtje shtetërore. Pa u ndalur për punën e rezultate të arritura në mjaft qytete, e cila aty filloi shumë më shpejt, e pati përfundime, që lexohen edhe sot. Duke qenë i lidhur më shumë me fshatin e me trashëgiminë e tij, po evidentoj dhe një fakt jo pak domethënës. Qysh në gjysmën e parë të viteve '70 (shek. XX), mbi bazën e një vendimi të nivelit të lart shtetëror (të nxitur e të inkurajuar nga personalitete shkencore të nderuara të kohës), kushtuar fshatit e ndërtimeve fshatare nga jugu në veri, u ngritën ekupe shkecore-teknike, në përbërjen e të cilëve u përfshinë dhe studentë të UT (u përfshi në programe mësimore). Nga ky gjurmim i organizuar, në krye të të cilit qëndronin specialistë të institucioneve shkencore, u mblodh dokumentacion i pasur grafik (skica e vizatime), fotografik e përshkrimor, për rreth një mijë objekte të arkitekturës fshatare. Dokumentacion i cili ndodhet në arkivat e IKP-së e të IMK-së. Dua të theksoj gjithashtu se, nëse për Kosovën trashëgojmë një punë gjithsesi të vlerët, kur është fjala për trevat me vendbanime shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi, përjashtuar ndonjë tajtesë keqdashëse nga joshqiptarë, mund të flitet e shumta për ndonjë trajtim sporadik dhe aq. Pa folur për ndërtimet tradicionale çame, të cilat presin (shpresa vdes e fundit), të gjurmohen, dokumentohen e studiohen. Ashtu si ajo e diasporës shqiptare (sidomos në Greqi, Itali, Egjipt; pse jo dhe në Bullgari, Kroaci, Rusi e ndonjë tjetër), ku praktikisht çdo gjë e lidhur me këtë fushë, ka mbetur jashtë vemendjes së studiuesve etnologë në radhë të parë.

Banesa, për natyrën e saj në aspektin funksional dhe në atë estetiko-artistik, është edhe *ndërtim i mirfilltë arkitektonik*. Ky realitet e bën atë edhe objekt studimi të arkitekturës. Po ndalem shkurt te ky aspekt të nderuar pjesëmarrës, pasi desha t'u bëj me dije se, nuk jam diplomuar për etnograf a etnolog, por për inxhinjer ndërtimesh qytetare, sikurse quhej ajo degë, mbi 40 vjet më parë në UT-në e kohës. Parë me këtë sy, kur është fjala për kohën që po jetojmë, natyrshëm mund të thuhet se, ky krijim arkitektonik e ka mbyllur tanimë ciklin e vet. Veçse me këtë pohim nuk do të ishte logjike, të nënkuptohej që ajo e ka mbyllur dhe misionin e vet. Madje përsa po them, mendoj se do të përbënte një temë diskutimi me interes, jo vetëm midis etnologësh, por sidomos me pjesëmarrje të specialistëve të sotëm, projektues a zbatues qofshin, të angazhuar me ndërtime të sotme, në qytet e në fshat. Gjithsesi besoj të kem mirëkuptim, nëse po skicoj kalimthi, ndonjë mendim. Të gjithë jemi dëshmitarë të faktit që sot po bëhen me ritme relativisht të shpejta, ndërtime të reja banimi. Veçse kam përshtypjen, qofsha i gabuar, se sikur po realizohen ndërtime ku shihet ashiqare që i janë shmangur tërësisht frymës e filozofisë së arkitekturës tradicionale të qendrës së banimit a të mbarë zonës. Natyrisht objektet për banim që vazhdojnë të realizohen, fjala vjen, në peisazhin e sotëm fshatar, janë komplekse e me prirje natyrash të ndryshme. Kur them kështu, nuk mund të injorohet fakti që çdo gjë fillon e mbaron me praninë e arkitektit apo specilaistit ndërtues të shkolluar. Mendoj se kam të drejtë të pyes: a mos vallë kthimi i vështrimit te e huaja, duke e injoruar totalisht vendasen, duhet marrë si shfaqje sigurie?, Si shfaqje pushteti? Apo si vallaha ombrelë ngritjeje shoqërore e kulturore? Dhe më tej: Mos vallë po na ulet disi shesh, mendësia sipas të cilës, më mirë kopjo të tjerët sesa të krijosh vetë? Dhe, po qëndron kjo e fundit, do të thotë se po na pushton një sëmundje e njohur e arkitekturës së kultivuar: *eklektizmi, formalizmi*. Nuk di pse por kam më shumë dëshirë ta quaj një korrent kalimtar. Dhe duke vazhduar me pyetje, a thua në të gjitha ciklet e shkollimit profesional, duke arritur deri në universitet, zhvillohet lënda e historisë së arkitekturës në përgjithësi dhe si pjesë e saj historia e arkitekturës shqiptare?

Më posht, duke e quajtur të hapur diskutimin, po ndalem në dy momente. Diku nga fundi i viteve '70 (*shek. XX*), isha në Prishtinë, në kuadrin e marrëveshjeve midis institucioneve të kohës. Pata rastin të takohem me një zëvendës-ректор (serb) të universitetit të Prishtinës. Në momentin që na prezantuan, shoqëruesi (i ndjeri arkitekt Agush Beqiri,

pedagog në atë universitet), më prezantoi te zëvendës-ректорi (i cili ishte mjek-kardiolog), si arkitekt. Mjeku, i cili më ka mbetur në kujtesë si një njeri i nderuar, duke më dhënë me shumë dashamirësi dorën, më thotë: *ne mjekët dhe ju arkitektët kemi diçka që na bashkon. Veprat tuaja qëndrojnë mbi tokë ndërsa tonat flenë nën tokë*. Duke qenë se gjuhën ruse atëherë e kishim si gjuhë nëne e babe, e përjetova të gjithë notën e humorit dashamirës të thënies, prandaj dhe iu përgjigja: Dhe ky ndryshim shkon më tej. Veprat tuaja lenë dhimbje që s'harrohen, kurse tona durohen... Kujtoj që patëm mirëkuptim të plotë. Momenti i dytë lidhte me fragmente që kam lexuar vite më parë në një libër të një arkitekti maqedonas, i cili mesa kam dijeni, ka ndërruar jetë në moshë relativisht të re. Fjala është për Dushan Grabijanin. Ky arkitekt pasi kish kryer universitetin me një program tërësisht perëndimor jashtë Maqedonisë, filloi të japë mësim në Shkup. Në procesin e dhënies së mësimi, e ndjeu se i mungonin tërësisht njohuritë për arkitekturën tradicionale të vendit të vet. Kjo e shqetësoi shumë, siç shkruan ai, prandaj dhe qysh në verën e parë, mori një grup studentash dhe filloi të hulumtojë, të mbledhi material e të njihet konkretisht me arritje të popullit të vet. Veprim që e çoi deri dhe në botimin e librit që thashë. Cilido koment për këto dy momente do ta kishte të tepërt komentim.

5. Në vend të mbylljes. Trashëgimia arkitektonike që u vu në fokus të kësaj kumtese, është pjesë natyrore e etnokulturës sonë. Ajo bart e përcjell vlera e mesazhe, të cilat mishërojnë nota idenditeti e individualiteti, për popullin e kombin tonë, me rrënjë të hershme në trojet e veta stërgjyshore. Botime të rendit shkencor të publikuara (pa munguar dhe në proces përgatitjeje e botimi) dhe pasuria e depozituar në arkiva (sidomos në IKP, në IMK e në IAP), janë burim autentik i pazëvendësueshëm, i cili u bën nder atyre që e kanë grumbulluar e sistemuar, sipas mundësive e rrethanave që ofronte koha. Kjo pasuri, së bashku me atë të shpallur Monument Kulture dhe përvoja e fituar, formojnë një bazë të shëndoshë e me vlera madhore propagandimi, njohjeje, vlerësimi e shqyrtimi për sot e për të ardhmen. Ato janë një *kujtesë* e një *thirrje* jo vetëm për specialistë, por dhe për pushtetarë e për qytetarë, lidhur me nevojën e ruajtjes e mundësisht të pasurimit të saj dhe jo për lënien në harresë, në mëshirën e fatit. *Thirrje* e *kujtesë* për fëmijë e të rritur, për mësues e nxënës, për pedagogë e studentë; për breza të sotëm e të nesërm. *Thirrje* e *kujtesë* për të përballuar sfidat me të cilat përballlet edhe kjo pasuri në kushtet e synimeve integruese që shtrihet koha. Sa e si do të mund të ruheshin në vazhdimësi e të integroheshin në realitetet e reja përpara të cilave

ndodhet shoqëria shqiptare në tërësi, pavarësisht kufijve aktualë të imponuar e jo të dëshëruar. Me qëllimin fisnik bashkëkohor që, jo vetëm të mos injorohen a t'i mbulojë pluhuri ogurzi i harresës, por të konservohen e ruhen sipas standarteve të sotme; ndërsa botimet të pasurohen me të reja, jo vetëm gjithpërfshirëse, por dhe të nivelit akademik. Ato diktojnë nevojën e ngutshme të përgatitjes së specialistëve të rinj, të cilët në përputhje me kërkesat e kohës, të dinë të përfitojnë nga përvoja dhe trashëgimia që po u lenë paraardhësit.

Dhe lidhur me botimet po shtoj sa më poshtë. Besoj jeni në dijeni se në Tiranë botohej përmbledhësi "Etnografia Shqiptare", numri i parë i të cilit ka dalë në fillim të viteve '60, ndërsa i fundit në mesin e viteve '90 (shek. XX). Në të gjithë numrat e tij, gjen jo pak artikuj edhe për tashëgiminë arkitektonike. Ndërprerja e botimit të saj, më duket (duke folur me nota të buta), një veprim paradoksal. E them këtë, pasi sikur aty të vazhdonte të pasqyrohej vetëm materiali përshkrimor e fotografik i mbledhur në vite dhe i depozituar në arkiv, shoqëruar me spjegime të nivelit profesional nga specialistë, do të ishte një pasuri e vyer. Qysh në vitet '80, u planifikua për botim (nën kujdesin e Akademisë së Shkencave), një seri me okielon Trashëgimia Kulturore e Popullit Shqiptar, ku vetëm për arkitekturën popullore u planifikua një seri me 4-5 vëllime. Praktikisht, duke zvaritur çdo gjë nën maskën e pamundësive për financim, prej tyre mezi doli vëllimi i parë vitet e fundit. Aty vihet në fokus kryesisht pellgu verior i trevave shqiptare, kryesisht brenda kufijve aktualë. Pyetja është, kur dhe pse nuk po punohet për përgatitjen e vëllimeve të tjera, madje me synime gjithpërfshirëse të trashëgimisë, të cilat do të çonin në një dokumentim e njohje të plotë e të gjithanshme të rrënjve tona etnike. Dhe mos harroni se jo vetëm janë larguar studiuesit më përvojë, por askujt s'i ka shkuar në mend të aktivizojë qoftë dhe një të ri.

Problem jo pa rëndësi, por përkundrazi, nevoja e përgatitjes dhe realizimit të projekteve për botime të niveleve akademike (Tiranë-Prishtinë-Tetovë), për mbarë trashëgiminë etnokulturore. Dhe këtu nuk është fjala për të manifestuar ndonjë notë nostalgjie, por për të mos harruar se kemi të bëjmë me një trashëgimi të vyer, e cila na bën vetëm nder. Natyrshëm lind pyetja: A mos vallë tanimë duhet hequr dorë nga studime të lidhura me rrugën e formimit e me tipare që bartin kulturat e etnive e të popujve si vazhdimësi natyrore e tyre? I bindur në mirëkuptim, do të përgjigjesha JO, pa asnjë hezitim. Kam mendimin se, jo vetëm nuk duhet hequr dorë, por përkundrazi. *Dija dhe kultura*, thotë i mençuri, janë të *mira universale*. Ato, pavarësisht ku janë lindur,

kultivuar e zhvilluar, u takojnë të gjithëve. Çka do të thotë, sipas një gjuhe të qartë e të thjeshtë se, mbetet nevojë ndriçimi e njohja edhe e aspekteve të tilla etnokulturore. Kjo të shtyn të ritheksoh se, duhen nxitur brezat e rinj, për të njohur me baza të shëndosha deri dhe aspekte kulturore të albanologjisë e ballkanologjisë, të cilat në masa e në forma të ndryshme, janë politizuar e deri nëpërkëmbur. Këtu desha të rikujtoj sado kalimthi se, nuk është rastësi fakti që në Shqipëri janë shpallur në cilësinë e *qyteteve-muze*, dy prej *kulmeve të krijimtarisë shqiptare e europiane*: Berati e Gjirokastra. Të dy këto qytete janë shpallur tanimë nga UNESCO, *qytete ndërkombëtare të kulturës*, duke u përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore botërore që mbrohet e menaxhohet edhe nga UNESCO. Prandaj ritheksoj me ngulm se, kjo trashëgimi, e pranishme në trojet tona, po përjeton shqetësime, që gjejnë shprehje te indiferenca në njohjen realitetit e në lënien pasdore të kualifikimit të specialistëve të rinj. Në një kohë që vihet re rrallim i ndjeshëm i specialistëve të vjetër (studiues, gjurmues e restauratorë). Indiferenca gjen shprehje te ndërprerja e botimeve të nivelit akademik; te propagandimi jo profesional e të mirëorganizuar të vlerave e arritjeve që përcjell kjo trashëgimi; te mos stimulimi, mos nxitja e fillimit dhe e vazhdimet të një pune profesionale me natyrë gjithpërfshirëse në trojet tona etj. E thënë pa doreza, ke frikë të pyesësh, fjala vjen, sa prej mbi 200 banesave fshatare të shpallura në vite si *monument kulture*, janë ende në këmbë dhe cili është fati real i atyre që kanë mbetur në këmbë. Po ashtu, krahas punës për ndërgjegjësimin e brezave që kalojnë nëpër cikle shkollimi nga më të ultat e deri te më të lartat, lidhur edhe me këtë trashëgimi etnokulturore, s'është harruar nevoja e organizimit të aktiviteteve shkencore me një tematikë nxitëse e inkurajuese përse a tha. Aktivitete jo vetëm me karakter kombëtar gjithpërfshirës, por dhe lokale, krahinore a zonale.

Ndriçimi e ruajtja e identitetit kulturor, nuk nënkupton humbjen nga busulla të nevojës së integritetit në kuptime bashkëkohore. *Objektivitet*, na kujton i mençuri, *do të thotë vërtetësi*. E vërteta, vazhdon ai, nuk pranon *shtrembërime*, *zburime* a *plotësime të pamenduara*. Kjo aksiomë e thjeshtë është kujtesë sidomos për mësimdhënës të të gjitha niveleve. Në trashëgiminë tonë etnokulturore është materializuar *memoria historike*. Sartri na kujton se, *ajo dukuri që nuk bëhet e njohur, harrohet e humbet shpejt*. Këtu po sjell në kujtesë sentencën, sipas të cilës, *e kaluara vjen e ndërhyr në të tashmen, duke mos rënë ndesh me aktualitetin*, por përkundrazi. Pra, edhe historia e kësaj fushe të etnokultuës, si e gjithë etnokultura, mbetet

mësuese e jetës, duke ofruar përvojë, potenciale e mundësi për shfrytëzimin e tyre e mospërsëritje a thellim gabimesh. Kjo trashëgimi dëshmon se, shqiptari nuk është marrë vetëm me jatagan a me altti, të cilat i ka mbajtur se ia ka imponuar jeta për t'u mbrojtur. Kujtoj se ende nuk kemi një tekst të nivelit akademik, të quajtur "Historia e Etnologjisë (a Etnografisë) Shqiptare" (apo thjesht "Etnologjia Shqiptare"), një pjesë të rëndësishme të të cilës do ta zinte dhe kjo trashëgimi. Edhe kjo histori, ndihmon të gjithë brezat, që të mos kenë frikë a neveri për të kaluarën e paraardhësve të vet dhe për kulturën e tyre. I mençuri thotë se, *pa trashëgimi, pa histori të kësaj trashëgimie e pa njohje të saj, do të ecësh si i trulllosur*. Për më tepër që globalizmi nënkupton lëvizjes të lirë të vlerave, duke mos injoruar identitetin, si pasuri e vlerë qytetërimi. Po kujtoj këtu me këtë rast një projekt me titull: Ditë të Trashëgimisë Kulturore Europiane. Ndër synimet e këtij projekti të tërheq vemendjen njëri prej objektivave të tij: *ruajtja e ndërgjegjësimit i opinionit publik të vendeve përkatëse, për potencialet reale që ofron kjo trashëgimi të secili prej tyre, si pjesë e trashëgimisë së madhe europiane, në të cilën konvergohet të gjitha vlerat e saj*. Pyetja që të vjen ndërmend është: sa dhe si jemi të përgatitur e të ndërgjegjësuar për të manifestuar ditë të tilla, ndonëse ka vite që flitet për to. Ndonëse, mesa kam njohuri, inisiativa nuk mungojnë, kam mendimin se jemi larg asaj që realisht dikton koha me kërkesat e saj. Mjaft të ndalem te një moment i thjeshtë në dukje por domethënës në përmbajtje. Sa e njohin e si punohet për ta njohur brezat e sotëm trashëgiminë e zonës a të vendbanimit të tyre? Po muzetë lokalë, rajonale a kombëtarë? Më ka bërë përshtypje një pasazh i lexuar diku, ku thuhej se, një ebre që jeton në Gjermani, di më shumë për Izraelin dhe për kulturën e popullit të vet, se një ebre që ka lindur e jeton në Izrael. Pyetja që të lind është: Po ne shqiptarët si jemi në këto aspekte, përfshirë këtu dhe emigrantët tanë të shpërndarë në shumë vende të botës? Një aspekt i thjeshtëzuar i përgjigjes do të ishte se, jo më traditat e trashëgiminë etnokulturore, por sikur po harrohet gjuha. Praktikisht trajektoret e hequra sot në praktikat rajonale, çojnë domosdoshmërisht edhe në bashkim të pjesëzave të Shqipërisë Natyrale në gjirin e Europës së Bashkuar. Po ashtu, në kohën tonë, sikur nuk ka vend për modele të ngushta *shtet-komb*. Edhe pse kështu, kjo nuk të pengon të shtrosh pyetjen: Përse gjithmonë ne shqiptarët duhet të rendim të parët për të adoptuar ndryshime që fqinjët tanë, edhe pse kanë përvojë shtetformuese krahasimisht më të madhe se ne, nuk ndërmarrin hapa të tillë? Shkurt muhabeti: A mos

duam të rrisim breza pa memorie historike? I mençuri thotë se, në fund të fundit, *qytetërimet e gjejnë shpëtimin e tyre te baza e lindjes. Qytetërimet humbin kur harrojnë nga kanë ardhur*. Dhe më tej: *Çdo gjë ushqehet duke mos humbur gjenezën e vet, çka do të çonte në tjetërsim e deri në zhdukje të identitetit e të individualitetit*, thotë një sentencë tjetër. Pluraliteti kulturor në këtë Ballkanin tonë, nuk pengon demokratizimin e tij, si një domosdoshmëri e patjetërsueshme. Pa harruar se, një komb nis të ndjejë e të drejtojë veten, vetëm atëherë kur mendon e punon për fatin e kulturës së vet. Pa i shkuar as në mend të rrënojë kulturën e tjetrit; a të ekzaltohet për shuarjen e kulturës së tjetrit, por duke e quajtur atë fatkeqësi. I mençuri thotë se, rruga për në Europë, kalon nëpërmjet kulturës që trashëgojnë popujt e saj.

6. Në mbyllje, duke qenë i bindur se në këtë sallë ka mësimdhënës të nivelit akademik, dua t'u rikujtoj vetëm me dashamirësi se, ndryshe nga shteti (në Tiranë, në Prishtinë a në Shkup qoftë), i cili zotëron fuqi ligjore e institucionale, janë mësimdhënësit ata që zotërojnë fuqinë praktike të hartimit, përpunimit e zbatimit të programit të arsimitit të rinisë. Ata duhet tua bëjnë të qartë atyre që marrin pjesë në leksione se, një popull që di të përballojë kohrat, dëshmon lartësi kulture, dëshmon nivel qytetërimi. Çka do të thotë se, popujt mbijetojnë në sajë të vetvetes. Prandaj dhe të mençurit thonë se, *e tashmja e një populli*, nga një anë është *bijë e të shkuarës* dhe nga ana tjetër, *e mbarsur me të ardhmen*. Vetëm kështu, mund të mendohet se do të shkruhet e pasqyrohet nesër historia reale e të sotmes në kulturë, në tërë përbërësit e saj.

Bibliografia:

- ÇABEJ, Eqrem (1987), *Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor*, "Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike", Tiranë.
- GRABIJAN, Dushan (1979), "Makedonska kuća ili prelaz stare orjentalne v sovremenu evropsku kuću", Ljubljana 1955 (sipas përkthimit shqip që ndodhet në AE-IKP).
- KRASNIQI, Mark (1979), "Gjurmë e gjurmime", Prishtinë.
- MUKA, Ali (2001), "Banesa fshatare dhe familja e madhe", monografi, Tiranë.
- MUKA, Ali (2006), *Ndërtimet tradicionale fshatare-monografi etnologjike*, Tiranë.
- MUKA, Ali (2004), *Shënime për fshatin dher ndërtimet fshatare në Kosovë*, "Perla" 1(32), Tiranë.
- RIZA, Emin (2005), *Vlerësimi i arkitekturës popullore në 40 vjet veprimtari të IMK*, "Monumentet" 2005, Tiranë.
- RIZA, Emin; HALITI, Njazi (2008), "Banesa qytetare kosovare e shekujve XVIII-XIX", Prishtinë.

THOMO, Pirro (1981), *Aspekte të njësisë dhe të larmisë në arkitekturën tonë popullore*, "Kultura popullore" 1, Tiranë.

ZOJZI, Rrok (1962), *Ndamja krahinore e popullit shqiptar*, "Etnografia Shqiptare" I, Tiranë.